



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec/Opština Orahevac/Municipality of Rahovec



**ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM
OPŠTINSKA KANCELARIJA ZA ZAJEDNICE I POVRATAK
OFFICE FOR COMMUNITIES AND RETURN**

Ky raport është një pasqyrim i aktiviteteve dhe angazhimeve të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) për periudhën Janar – Shtator 2023. Fokusi kryesor i kësaj zyre është në përmirësimin e situatës së komuniteteve jo-shumicë në Komunën e Rahovecit dhe zhvillimin e aktiviteteve në fushën kulturore, arsimore, dhe edukative, përfshirë promovimin e vlerave të diversitetit etnik, të drejtave të njeriut dhe komuniteteve, Riatdhesimit, Kthimit të qëndrueshëm dhe Migrimit.

Synimi kryesor i ZKKK-së për vitin 2023 përfshin:

- Përmirësimin e gjendjes së komuniteteve jo-shumicë në Komunën e Rahovecit.
- Përmirësimin e infrastrukturës.
- Zhvillimin e aktiviteteve kulturore, arsimore dhe edukative.
- Fasilitasi, Integrimi dhe zhvillimi i pozitës së të Kthyerve nga vendët e rajonit dhe Riatdhesimit nga vendët e treta.
- Fushata sensibilizuese në çështje jetike si arsimi, shëndetësia, barazi gjinore dhe multikulturalizmi.
- Ngritjen, zhvillimin profesional dhe mbështetjen e start-up bizneseve për komunitetin jo-shumicë në Komunën e Rahovecit.

Objektivat e përgjithshme të ZKKK-së përfshijnë përmirësimin e gjendjes së komuniteteve jo-shumicë në të gjitha çështjet jetike, implementimin e planit të punës dhe strategjive të nivelit qëndror, promovimin e kulturës dhe identitetit të komuniteteve jo-shumicë, monitorimin e projekteve edukative, përmirësimin e infrastrukturës rrugore, zhvillimin e aktiviteteve të shumta, bashkëpunimin me komunitetin dhe organizatat jo-qeveritare (OJQ), integrimin e të gjithë fëmijëve në procesin edukativo-arsimor, dhe fuqizimin e multikulturalizmit dhe bashkjetesës ndëretnike.

Raporti gjithashtu përshkruan aktivitetet dhe angazhimet në fusha të ndryshme si arsimi, shëndetësia, riatdhesimi, kthimi i qëndrueshëm, siguria, strategjitë/planet e veprimit, komiteti për komunitete, pjesëmarrja në aktivitete, trajnime dhe konferenca, dhe sfidat e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në punësimin në sektorin publik.

Raporti jep një pasqyrim të gjerë të përpjekjeve dhe aktiviteteve të ZKKK-së për të përmirësuar gjendjen e komuniteteve jo-shumicë në Komunën e Rahovecit dhe promovuar diversitetin kulturor dhe identitetin e tyre. Ky është një ndërmarrje e rëndësishme për të përmirësuar kualitetin e jetës dhe të drejtat e këtyre komuniteteve.

ARSIM

Aktivitetet dhe angazhimet që janë realizuar në fushën e arsimit nga Zyrja Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) janë të rëndësishme për përmirësimin e cilësisë së arsimit për komunitetet Rom, Ashkali, dhe Egjiptian në Komunën e Rahovecit. Disa nga këto aktivitete janë:

1. Programi "QENDRA MËSIMORE ME BAZË NË KOMUNITET/shkollë":

ZKKK – është në process të kërkimit të donatorëve për të marrë në menagjim qendrenë në fjalë në bazë të udhëzimit administrativë , licensimit , dhe menagjimin e qendrave në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit .

2. Fasilitimi i aplikimeve për bursa për shkolla të mesme dhe universitete:

Fasilitimi është bërë me qëllim të gjithëpërfshirës dhe mbështetjes nxënësve dhe studenteve të komuniteteve nga DKA-ja , e cila vie me qëllim të një ndihmë të rëndësishme për nxënësit e komuniteteve jo-shumicë, me synim të lehtësojnë dhe të ndihmojë në mundësimin e tyre për të ndjekur arsimin e lartë.

3. Fasilitimi i përdorimit të shërbimeve të E-Kosovës:

ZKKK-ë në Rahovec ka fasilituar në procesin e Aplikimeve online për subvencionimin e librave , për përpjekje për të ndihmuar familjet që kanë fëmijë në shkollë të sigurojnë librat e nevojshëm shkollorë dhe përjashtimit të dështimeve në aplikim si mungesë e përdorimit të sistemit online dhe mungësës së paisjeve elektronike.

4. Trajnimi për ngritjen e kapaciteteve në arsimin gjithëpërfshirës "INCLUDE" në kuadër të Këshillit të Europës:

Ky trajnim është një hap i rëndësishëm për përmirësimin e arsimit për nxënësit me nevoja të veçanta dhe komuniteteve jo-shumicë.

5. Fushata sensibilizuese për regjistrimin me kohë të fëmijëve të komuniteteve jo-shumicë në klasë të parë.

Këto aktivitete tregojnë përpjekjet e ZKKK-së për të përmirësuar aksesin dhe cilësinë e arsimit për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe për të inkurajuar përdorimin e teknologjisë dhe shërbimeve online për përfitimin e tyre. Është një hapat pozitiv në drejtim të përmirësimit të situatës së arsimit për këto komunitete.



SHËNDETSI, MIRQENJE SOCIALE, FUSHATA NDËRGJEGJËSUESE :

Aktivitetet në sektorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies sociale , të realizuara nga Zyrja Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) janë të rëndësishme për sigurimin e kujdesit shëndetësor dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve jo-shumicë në Komunën e Rahovecit. Disa nga këto aktivitete janë:

1. Vaksinimi i rregullt i fëmijëve:

Bashkëpunimi me UNICEF dhe BALLKAN SUNFLOËER për vaksinimin e rregullt të fëmijëve është një hap i rëndësishëm për të siguruar që fëmijët e komuniteteve të përfshira të mbrohen nga sëmundjet.

2. Fushata vetëdijesuese për vaksinimin e fëmijëve:

Kjo fushatë ka për qëllim të edukojë prindërit dhe kujdestarët mbi rëndësinë e vaksinimit të rregullt të fëmijëve, duke ndihmuar në parandalimin e sëmundjeve.

3. Fushata vetëdijesuese mbi mbrojtjen nga sëmundjet kronike:

Ky është një hap i rëndësishëm për të edukuar komunitetet mbi rëndësinë e mbrojtjes nga sëmundjet kronike si diabeti, hipertensioni, dhe të tjera, intervenimi në kontrolla mamografike dhe gjinekologjike falas . Kto informacion dhe shërbime janë ofruar gjatë prejdhës Janar-Shtator dhe kanë pasur për synim parandalimin e këtyre sëmundjeve si pasojë e kujdesit të dobët.

4. Inspektimi procesit të të riatdhesuarve :

Kjo është një përpjekje e rëndësishme për të siguruar që të riatdhesuarit të kenë kushte të mira banimi pas kthimit në komunitet , mbështetjes me qira , plan biznese , trajnime profesionale dhe mbështetjes me ushqime.Procesi i riatdhesimit është ndjekur dhe ka përfshirë vlerësimin e



kërkesave të të riatdhesuarve dhe ofrimin e mbështetjes për ta , bazuar në rregulloren në fuqi dhe rekomandimeve të komisionit për riatdhesim .



KTHIM I QËNDRUSHËM :

Aktivitetet lidhur me kthimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar janë thelbësore për përmirësimin e situatës së këtyre individëve dhe për të siguruar një riatdhesim të suksesshëm. Në këtë rast, disa nga veprimet dhe zhvillimet e ZKKK-së janë:

1. Trajnim i zyrtarëve:

Trajnimet e dy zyrtarëve të ZKKK-së mbi menaxhimin e databazës dhe sistemit për kthim të qëndrueshëm janë të rëndësishme për sigurimin e një përgatitjeje të mirë dhe të profesionalizmit në menaxhimin e kthimit të qëndrueshëm.

2. Aprovimi i Planit të Veprimit për Kthim të Qëndrueshëm 2023-2025:

Aprovimi i Planit të Veprimit për Kthim të Qëndrueshëm 2023-2025 në Kuvend tregon përkushtimin e autoriteteve lokale për të kujdesur për personat kthyer nga vendët e rajonit dhe për të ofruar mbështetje për integrimin e tyre.

3. Takime me UNHCR-in dhe Ministrinë për Komunitete dhe Kthim:

Zyrtaret e ZKKK-së , kanë realizuar takime me përfaqësuesit e UNHCR dhe Ministrinë për Komunitete dhe Kthim janë rëndësore për koordinimin dhe bashkëpunimin në lidhje me procesin e kthimit. Kjo mund të përfshijë vlerësimin e nevojave dhe mundësitë për të riatdhesuarit dhe përmirësimin e programit të riatdhesimit.



Realizimi i këtyre aktiviteteve tregon përkushtimin e ZKKK-së për të përmirësuar kujdesin shëndetësor dhe mirëqenien e komuniteteve të përfshira, riatdhesimin ,dhe kthimin e qëndrueshëm . Përmes bashkëpunimit me drejtoritë përkatëse , organizata ndërkombëtare dhe lokale, që janë realizuar një gamë e gjerë veprimesh që synojnë të sigurojnë që komunitetet të kenë akses të barabartë në kujdesin shëndetësor dhe të informohen mbi shëndetin dhe mirëqenien e tyre. Përmes trajnimeve, planifikimit strategjik dhe bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare, pritet që ky proces të jetë sa më i ndihmueshëm dhe i suksesshëm për të riatdhesuarit dhe të kthyrve nga vendet e rajonit.

SIGURI , STRATEGJI / PLANET VEPRIME:

Angazhimi i ZKKK-së në çështjet e sigurisë dhe zhvillimit të strategjive dhe planeve të veprimit për komunitetin Rom dhe Ashkali , Riatdhesim , dhe Kthim të Qëndrushem 2023-2025, tregojnë një përpjekje të qëllimshme për të përmirësuar situatën komuniteteve dhe qytetarëve të komunës së Rahovecit. Disa nga veprimet e ndërmarra janë:

1. **Pjesëmarrja e zyrtareve të ZKKK-së në takime të Këshillit për Siguri në Bashkësi:** Pjesëmarrja e stafit të ZKKK-së në 5 prej këtyre takime tregon se është duke u ndjekur dhe monitoruar vazhdimisht gjendja e sigurisë për komunitetet jo-shumicë. Kjo është e rëndësishme për të siguruar që komunitetet të kenë një ambient më të sigurt dhe më të mbrojtur.
2. **Takime me KFOR-Austriak:** Komunikimi dhe bashkëpunimi me trupat e KFOR-it tregon se ZKKK është e përkushtuar për sigurinë dhe mirëqenien e komuniteteve jo-shumicë. Kjo është një ndihmë e rëndësishme në sigurimin e një mjedisi më të sigurt.

Permbledhja e realizimin të planeve të veprimit nga Zyra për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) në Rahovec për periudhën Janar-Shtator është si vijon:

1. **Plani i Veprimit për Përfshirjen e Komunitetit Ashkali dhe Rom 2023-2025:** - Kjo strategji në kuadër të planit të veprimit , është miratuar dhe është përdorur për të promovuar përfshirjen dhe zhvillimin e komunitetit Ashkali dhe Rom për prejdhën 2023-2025 . - Projekte specifike janë implementuar për të adresuar nevojat e këtyre komuniteteve, në 5 komponenta përfshirë arsimin, shëndetësinë dhe mirqenjes sociale , dhe qasjen në punësim , strehim dhe banim dhe luftimin e diskriminimit.
2. **Plani i Veprimit për Kthim të Qëndrueshëm:** - Ky plan është realizuar me sukses për të ndihmuar personat që janë kthyer nga vendet e rajonit në vendlindje pas një periudhe të largimit. – Qellimi i këtij dokumenti , ka për synim përmirësimet në shërbime , integritet të plotë, përmisimin e ambientit infrastrukturorë, shërbime sociale dhe ekonomi lokale për të siguruar një kthim të qëndrueshëm dhe një jetë më të mirë.
3. **Plani i Veprimit për Riintegrim dhe Integrim të Personave të Riatdhesuar 2023-2025:** - Kjo strategji është zbatuar për të ndihmuar personat e riatdhesuar të integrohen në shoqërinë e tyre të re dhe të kenë mundësi të krijojnë një jetë të qëndrueshme. - Përmes trajnimeve, punësimit, dhe ndihmës sociale, është promovuar riintegrimi i tyre me sukses.



4. **Plani i Veprimit për Banim Social 2022-2024:** - Ky plan është miratuar dhe është implementuar për të adresuar çështjet e banimit social në komunën e Rahovecit . - Ndërtimi i banesave të reja dhe ofrimi i shërbimeve të nevojshme për banorët janë bërë prioritet për të mbështetur personat e nevojshëm. Ky raport është një pasqyrë e përgjithshme e veprimeve të ndërmarra nga Zyra për Komunitete dhe Kthim në Rahovec për realizimin e këtyre planeve të veprimit.

Detajet dhe arritjet e mëtejshme mund të përfshihen në raportin përfundimtar sipas nevojës.

PJESËMARJA E ZYRTAREVE TË ZKKK-SË NË KOMITETIN PËR KOMUNITETE , VIZITA NË VENBANIMET E KOMUNITETVE JO-SHUMICË :

1. Pjesmarrja në takime e Komitetit për Komunitete:

Gjatë prejdhës Janar-Shtator , zyrtarët e ZKKK-së , kanë marrë pjesë në 5 takime të Komitetit për Komunitete , me qëllim për të kuptuar më mirë nevojat dhe shqetësimet e komuniteteve dhe për të koordinuar veprimet e ndërmarrura për përmirësimin e tyre , ZKKK ka raportuar mbi ecurinë e aktiviteteve dhe ka pranuar rekomandimet nga antaret e komitetit për aderimin e çështjeve në favor të komuniteteve .

2. Vizitat në lagjet dhe vendbanimet e komuniteteve jo-shumicë:

Vizitat në lagje dhe vendbanime të komuniteteve, shkollave mikes me përbërje të komuniteteve , qendrave me bazë në komunitet , janë treguar gjithnjë një mënyrë efektive për të vlerësuar situatën direct në terren , me njoftimin mbi kushtet e tyre dhe për të komunikuar drejtpërdrejtë me banorët. Kjo ka ndihmuar në identifikimin e nevojave specifike të tyre dhe në zhvillimin e projekteve të përshtatshme posaqerisht në infrastruktur



dhe çështje të tjera për mirqenjen e tyre.

3. Raportimi periodic i ZKKK-së:

Raportimi i rregullt për realizimin e aktiviteteve është një mënyrë e rëndësishme për të mbikëqyrur progresin dhe për të ndarë informacionin me komunitetin dhe palët e interesuara. Ky raportim ndihmon në transparentë dhe llogaridhënie ndaj përfshirjes



dhe zhvillimit të komunitetit, shefi i ZKKK-së në menyrë të rregull raporton në mbledhjen e bordit të drejtorëve mbi gjendjen dhe aktivitetet që ndërlidhen me çështjet e zyrës .

TAKIME , TRAJNIME , PUNTORI , KONFERENCA DHE AKTIVITETE:

Përmes pjesëmarrjes në aktivitete, trajnime dhe konferenca, ZKKK ka treguar angazhimin e saj ndaj përmirësimit të situatës së komuniteteve jo-shumicë dhe promovon ndërgjegjësimin dhe edukimin në fusha të ndryshme për komunën e Rahovecit . Disa nga aktivitetet dhe veprimet që janë realizuar janë:

- Takimet e rregullta me stafin: Kjo është një praktikë e mirë për koordinim të brendshëm dhe sigurimin që çdo person në staf të jetë në dijeni të detyrave dhe obligimeve të tyre. Kjo ndihmon në menaxhimin efikas të aktiviteteve të përditshme.
- Trajnimi kundër dhunës në familje: Pjesëmarrja në trajnimin për kundër dhunës në familje tregon ndërgjegjësimin për një problem serioz shoqëror dhe përpjekjet për të ndihmuar komunitetet jo-shumicë që të kuptojnë dhe të luftojnë këtë problem.



- Pjesëmarrja në aktivitetet e 15-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës: Kjo tregon angazhimin ndaj ngjarjeve të rëndësishme historike dhe kujdesin ndaj përfshirjes së komuniteteve jo-shumicë në këto ngjarje.
- Takimet me përfaqësuesit e OSCE-së: Kjo përbën një mënyrë për të ndërtuar kontakte të rëndësishme me organizata ndërkombëtare dhe për të mbështetur politikat dhe

qëllimet për përmirësimin e komuniteteve jo-shumicë.

- Takimet me Ministrin për Komunitete dhe Kthim, MAPL-në , MKRS-në ,Ministrinë e Drejtësisë: Takimet me përfaqësuesit zyrtarë të qeverisë janë një mënyrë për të koordinuar veprimet dhe për të siguruar mbështetje për projektet në të mirë të komuniteteve.
- Trajnimi për Menaxhimin e Granteve: Ky trajnim është i rëndësishëm për menaxhimin e burimeve financiare dhe për të siguruar që projektet të financohen dhe zbatohen në mënyrë të efektshme.
- Monitorimi dhe raportimi mbi ecurinë e Strategjisë së Komuniteteve Rom dhe Ashkali: Kjo është një mënyrë e rëndësishme për të vlerësuar se sa suksess ka pasur strategjia dhe për të ndihmuar në përmirësimin e saj në të ardhmen.



- Trajnim për të rinjtë e komuniteteve jo-shumicë "Mundësitë mes nesh": Ky trajnim ka për qëllim të ndihmojë të rinjtë të zhvillojnë aftësitë dhe të njohin mundësitë për zhvillim personal dhe profesional.
- Degjimi buxhetor me komunitetet jo-shumicë: Ky është një praktikë e rëndësishme për të dëgjuar shqetësimet dhe nevojat e komuniteteve dhe për t'u siguruar që buxheti i komunës të reflektojë ato nevoja.
- Roli dhe rëndësia e grave Rom, Ashkali dhe Egjiptiane në vendimarrje: Kjo tregon ndërgjegjësimin për nevojën e përfshirjes së grave në proceset vendimmarrëse dhe të drejtat e tyre.



- Fushata sensibilizuese për regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë: Kjo është një mënyrë për të ndihmuar në regjistrimin e fëmijëve dhe për t'i siguruar atyre mundësinë për arsimim.
- Inicimi i projekteve kapitale në bashkëpunim me MAPL: Këto projekte përfshijnë punë në infrastrukturën e lagjeve dhe mund të përmirësojnë jetën e komuniteteve dhe pritet intervenimi në kanalizim në lagjën e epërm dhe gropa septike në fsh. Ratok (projeti është në proces të



fillimit pasi janë kryer procedurat e prokororit).

- Forcimi i kapaciteteve të stafit për zbatimin e ligjit mbi azilin dhe të huaj: Ky trajnim është i rëndësishëm për të ndihmuar të huajt dhe refugjatët në Kosovë.

- Fushata ndërgjegjëse për regjistrimin civil: Ky është një veprim që ndihmon në sigurimin e dokumentacionit civil për komunitetet që nuk janë të regjistruar në librat amë.

- Vizita në institucione qeveritare,

organizata lokale dhe ndërkombëtare: Këto vizita janë realizuar në ndërtimin e kontakteve dhe në koordinimin me partnerët.

- Takimi me Kryeministrin e Kosovës për situatën e komunitetit egjiptian në Kosovë: Ky takim është realizuar në përpjekjet për të adresuar shqetësimet specifike të këtij komuniteti.
- Emission televiziv mbi gjendjen e komuniteteve në Komunën e Rahovecit: Ky është një mënyrë për të sensibilizuar opinionin publik dhe për të informuar më shumë mbi situatën e këtyre komuniteteve dhe promovimit të projekteve të komunës së Rahovecit.
- Kontrolla gjinekologjike dhe mamografi falas për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptiane në Rahovec dhe Gjakovë: Ky është një veprim i rëndësishëm për të siguruar kujdes shëndetësor për gratë e këtyre komuniteteve si grupe të cënushme, dhe deri me tani janë realizuar mbi 50 kontrolla sosh.



- UN Kosovo Youth Event - UNMIK: Pjesëmarrja në këtë event është një mënyrë për të prezantuar çështjet dhe nevojat e të rinjve të komuniteteve Rom, Ashkali, Egjiptian dhe Serbë në nivel ndërkombëtar dhe rajonal.
- Këto aktivitete dhe projekte tregojnë përkushtimin e ZKKK-së për përmirësimin e jetës së komuniteteve jo-shumicë në Komunën e Rahovecit dhe për të ndihmuar në zhvillimin e tyre në të gjitha sferat.

